



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

Legjislatura IV  
Komisioni për Buxhet dhe Financa  
Mbledhja nr. 65/12  
Prishtinë, më 23.05.2012, ora 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla 302

**PROCESVERBAL**  
**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA**

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Duda Balje, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Xhevdet Neziraj dhe Muhamet Mustafa.

Mungoi: Albana Fetoshi.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli, Ardita Fejza (praktikante), Dafina Krasniqi (praktikante).

Gjithashtu ishin të pranishëm: Nexhat Shatri – Zyra e Presidentit, Shkumbin Beqiri nga KDI, Haxhi Gashi nga USAID/Deloite.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit dt. 8.05.2012;**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-110 për Ndërtime me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;**
4. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-102 për komunikimet elektronike me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;**
5. **Shqyrtimi i Raportit financiar të Komisionit për Ndihmë Juridike për vitin 2011;**
6. **Të ndryshme.**

**1. Miratimi i Rendit të ditës**

**Kryetarja**, lidhur me Marrëveshjen për Statusin e Forcave të Huaja të nënshkruara në mes Qeverisë së Kosovës dhe SHBA-ve, për të cilën është diskutuar në mbledhjen e kaluar të Komisionit dhe e cila është

shtyer për shkak nevojës për konsultime shtesë dhe mungesës së materialit, propozoj që të futet si pikë shtesë e rendit të ditës dhe të jetë pika e

Rendi i ditës miratohet njëzëri me plotësime. Shtohet pika e re e rendit të ditës- pika e gjashtë: Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Këmbimit të Notave Diplomatieke për Statusin e Forcave të Huaja mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës

## **2. Miratimi i procesverbalit të datës 08.05.2012**

**Kryetarja**, konstatoi se procesverbali nga mbledhja e mbajtur më 08.05.2012, miratohet unanimisht.

## **3. Shqyrtimi i projektligjit Nr.04/L-110 për Ndërtime me Raportin me amendamente të komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;**

**Kryetarja**, theksoi se projektligji dhe amandamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Komisioni njëzëri nxori këtë:

### **REKOMANDIM**

Projektligji për Ndërtime dhe amendamentet e komisionit funksional, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

## **4. Shqyrtimi i projektligjit nr. 04/L-102 për komunikimet elektronike me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri**

**Kryetarja**, njoftoi se grupi punues ka shqyrtuar projektligjin dhe amendamentet e komisionit funksional, dhe në nenet që kanë pasur të bëjnë me buxhetin dhe financat, e të cilat nuk kanë qenë të rregulluara mirë dhe në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe ligjet tjera në fuqi, i ka propozuar Komisionit ndryshimet konkrete. Rekomandimi i parë për ndryshim ka të bëjë me nenin 79, janë ndryshuar paragrafët 4, 5 dhe 6, ku është përcaktuar se Bordi i Autoritetit nuk është staf civil, ndërkaq stafi tjetër duhet të trajtohet si staf civil dhe të paguhet në pajtim me Ligjin për Pagat e Shërbimit Civil. Me paragrafin 6 kemi rekomanduar që struktura organizative të përcaktohet nga bordi në përputhje me ligjet në fuqi.

**Amendamenti 1** i propozuar nga grupi punues miratohet njëzëri.

Në amendamentin 2 që i referohet nenit 81, është përcaktuar se burimet e financimit të autoritetit të sigurohen nga buxheti. Po ashtu Autoriteti përgatit projektbuxhetin dhe e dorëzon për shqyrtim dhe miratim në Kuvend. Autoriteti rregullativ është i obliguar t'i paraqes Kuvendit raport më se largu deri më 30 mars të vitit vijues dhe të bëjë auditimin. Kurse neni

**Amendamenti 2** i propozuar nga grupi punues miratohet njëzëri.

Në amendamentin 3 që ka të bëjë me nenin 83, në grupin punues jemi akordu që pagesat të cilat bëhen në autoritetin rregullativ dhe telekomunikacion të derdhen në buxhetin e Republikës së Kosovës, pastaj nga buxheti mjete destinohen për autoritetin rregullativ dhe për mjetet e tyre vendos Kuvendi. Ne kemi

marrë informatën nga Ministri i Financave dhe të gjitha të hyrat shkojnë në thesar dhe pastaj mjetet shpërndahen nëpër institucionet përkatëse sipas nevojave të tyre.

**Amendamenti 3** i propozuar nga grupi punues miratohet njëzëri.

Amendamenti 4, ka të bëjë me propozimin për ndryshimin e nenit 58, përkatësisht me heqjen e fjalës jobuxhetor, të komisionit funksional e cila autoritetin rregullativ e bënë si organizatë jobuxhetore, në takimin e fundit të gjithë anëtarët e komisionit kanë qenë që të hiqet fjala jobuxhetor.

**Amendamenti 4** i propozuar nga grupi punues miratohet njëzëri.

**Sali Asllanaj**, me amandamentet e propozuara janë ofruar zgjidhje të cilat konceptualisht janë më ndryshe nga propozimi fillestar i projektligjit që ka ardhur. Ideja ka qenë që të mos ketë shumë vijues të buxhetit të ndryshëm por të jetë një buxhet i Kosovës dhe në asnjë mënyrë asnjë agjension të mos ketë të ardhura të dedikuara. Me këto zgjidhje kemi bërë një disiplinë buxhetore më të madhe që këto mjete të grumbullohen në buxhetin e Kosovës dhe ndahen me ligj.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

## **REKOMANDIM**

**I.** Projektligji nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike, nuk përmban implikime buxhetore shtesë, me përjashtim të nenit 79, paragrafi 4, 5 dhe 6, nenit 81 dhe nenit 83.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, propozon amendamentet si në vijim:

Nenit 79, paragrafi 4 ndryshohet si vijon:

4. Anëtarët e Bordit nuk e kanë statusin e shërbyesit civil. Anëtarët e Bordit paguhën në bazë të skemës së pagave dhe mëditjeve për anëtarët e Bordeve të Pavarura dhe miratohet nga Kuvendi i Kosovës për çdo vit me Ligjin e Buxhetit vjetor deri në nxjerrjen e ligjit për pagat e funksionarëve publik ose ligji tjetër që rregullon këtë fushë.

Neni 79, paragrafi 5 ndryshohet si vijon:

5. Statusi i stafit profesional të Autoritetit trajtohet sipas Ligjit për shërbimin civil në Kosovë dhe paguhën sipas Ligjit për pagat e shërbyesve civil.

Neni 79, paragrafi 6 ndryshohet si vijon:

Struktura Organizative percaktohet nga Bordi në përputhje me ligjet në fuqi.

## **Amendamenti 2**

Neni 81, ndryshohet si vijon:

### **Neni 81 Financimi dhe Buxheti i Autoritetit**

1. Burimet e financimit të Autoritetit sigurohen nga Buxheti i Kosovës.
2. Autoriteti përgatit projektbuxhetin dhe dorëzon për shqyrtim dhe miratim në Kuvend në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
3. Autoriteti duhet të mbajë llogari të plota dhe të sakta të shpenzimeve faktike si dhe auditimin e pasqyrave financiare, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontabilitet dhe auditim në Republikën e Kosovës.
4. Autoriteti i raporton Kuvendit për shpenzimet buxhetore me raport vjetor më së voni me 30 Mars të vitit vijues kalendarik dhe raportim të veçantë kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi.

### **Amendamenti 3**

Neni 83, ndryshohet si vijon:

#### **Neni 83 Pagesat**

1. Në Buxhetin e Kosovës bëhen pagesat lidhur me veprimtarinë e Autoritetit si në vijim:
    - 1.1. Pagesa për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike, sipas përcaktimeve në nenin 27 të këtij Ligji;
    - 1.2. Pagesa për financimin e shërbimit universal;
    - 1.3. Pagesa për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, sipas përcaktimeve në nenin 57 të këtij Ligji;
    - 1.4. Pagesa për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe të serive numerike;
    - 1.5. Pagesat nga dënimet ekonomike të shqiptuara nga Autoriteti;
  2. Çdo taksë apo pagesë tjetër e paraparë me këtë ligj depozitohen në Buxhetin e Kosovës.
- II.** Amendamentet e propozuara nga Komisionin Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për Projektligjin nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë, me përjashtim të amendamentit 58.

### **Amendamenti 4**

Në amendamentin 58 që i referohet ndryshimeve në nenin 78 paragrafi 1, fshihet fjala **“jo-buxhetor”**.

#### **5. Shqyrtimi i Raportit financiar të Komisionit për Ndihmë Juridike për vitin 2011**

**Kryetarja**, kemi shqyrtu raportin financiar për ndihmë për ndihmë juridike dhe kemi kërkuar që të bëjë një detalizim të shpenzimeve. Në raportin e dërguar nga KNJ shofim që brenda kategorive kanë bërë lëvizje dhe tejkalim të shpenzimeve. Planifikimi i buxhetit nga ana e këtij institucioni nuk është bërë në rregull dmth nuk i kanë parapa si duhet shpenzimet dhe është dashur gjatë vitit pastaj më bërë transfere të ndryshme. Mund të bëjmë rekomandim që auditori të konstatojë arsyeshmërin e tejkalimit të këtyre shpenzimeve nëpër kategori të ndryshme ekonomike.

Komisioni, njëzëri nxori këtë

## REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin financiar të Komisionit për Ndihmë Juridike për vitin 2011, me vërejtjet e ngritura nga komisioni.

### **6. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Këmbimit të Notave Diplomatieke për Statusin e Forcave të Huaja mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës**

**Kryetarja**, në mbledhjen e kaluar nuk e kemi pas materialin e kompletuar tash ka arrit materialin e kompletuar. Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare, shifet shofim se nuk përmban implikime shtesë buxhetore.

**Naser Osmani**, pas informatave dhe bisedës me Presidencën është mësuar se kjo çështje ka qenë e rregulluar me Rregullore e UNMIK-ut dhe forcat SOFA, kanë qenë të përjashtuar prej çdo tatimi dhe takse, dhe si e tillë marrëveshje nuk ka implikime buxhetore. Mirëpo çështja është që SOFA dëshiron një marrëveshje të re me institucionet e Republikës së Kosovës.

Pas diskutimeve, Komisioni nxori këtë

## REKOMANDIM

Projektligji për Ratifikimin e Këmbimit të Notave Diplomatieke për Statusin e Forcave të Huaja mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, nuk përmban implikime buxhetore shtesë, dhe i rekomandon Kuvendit për ratifikim.

### **7. Të ndryshme.**

**Kryetarja**, një njoftim për anëtarët e komisionit, ju jeni në dijeni edhe nga mjetet e informimit që po planifikohet që të bëhet vlerësimi i buxhetit, sot sekretari më ka njoftuar që Kuvendi donë më paraqit një kërkesë për plotësim ndryshimet e buxhetit të Kuvendit. Meqenë se material do të shpërndahet sot, do të jetë pikë shqyrtim në mbledhjen e radhës së komisionit.

**Xhevdet Neziraj**, theksoi se në media po shkruhet se partitë politike po marrin mjete në shumën prej 0.35%, e që në fakt është shuma 0.17%. Do të duhej sqaruar kjo situatë, sepse njerëzit janë të informuar gabimisht dhe pyesin se qfarë po bëhet gjithë ato mjete.

**Mbledhja përfundoi: 11:50**

**Përgatitur nga:**

**Njësia për mbështetjen e Komisionit**

**Kryetarja e Komisionit**

---

**Safete Hadergjona**